

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË
ARSIMIN E LARTË



RAPORT TEMATIK

LIDHJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME TREGUN E PUNËS

Dhjetor 2025



www.ascal.al




info@ascal.al

Analizë e bazuar në Raportet e Vlerësimit të Jashtëm të ASCAL
për proceset e akreditimit të programeve të studimit në
gjashtëmuorin e parë të vitit 2025.

© AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË – ASCAL

 info@ascal.al

 www.ascal.al

 Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr. 8, Shkalla 1
Tiranë, Shqipëri

 [Facebook](#)

 [Instagram](#)

 [LinkedIn](#)

PËRMBAJTJA

1.	HYRJA, METODOLOGJIA DHE KONTEKSTI ANALITIK	4
1.1.	Hyrje.....	5
1.2.	Metodologjia.....	6
1.3.	Kuadri i përgjithshëm i të dhënave të analizuara	7
2.	ANALIZA TEMATIKE E GJETJEVE	10
2.1.	Kërkesat e tregut të punës dhe mekanizmat e përfshirjes së aktorëve të jashtëm.....	11
2.2.	Praktika profesionale dhe lidhja me tregun e punës.....	12
2.3.	Kompetencat dhe aftësitë e studentëve në raport me kërkesat e tregut të punës.....	14
2.4.	Punësimi dhe gjurmimi i të diplomuarve.....	16
2.5.	Aktivitetet mbështetëse për karrierën dhe punësueshmërinë	17
3.	ANALIZA KRAHASUESE E GJETJEVE.....	19
3.1.	Analiza krahasuese sipas fushave të studimit.....	20
3.2.	Analiza krahasuese sipas organizimit ligjor të institucionit (publik/jopublik)	23
4.	PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	26
4.1.	Përfundime të përgjithshme	27
4.2.	Rekomandime.....	29

1. HYRJA, METODOLOGJIA DHE KONTEKSTI ANALITIK

1.1.Hyrje

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), në përmbushje të misionit të saj ligjor dhe institucional, luan një rol kyç në garantimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Përmes proceseve të sigurimit të jashtëm të cilësisë, ASCAL vlerëson përmbushjen e standardeve shtetërore nga institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit, si dhe harmonizimin e tyre me Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë (ESG), duke nxitur një kulturë institucionale të cilësisë, transparencës, përgjegjshmërisë publike dhe përmirësimin të vazhdueshëm.

Në këtë kuadër, raportet tematike përbëjnë një instrument strategjik të rëndësishëm të veprimtarisë së ASCAL, pasi mundësojnë analizimin e strukturuar të tendencave, gjetjeve dhe problematikave të konstatuara gjatë proceseve të vlerësimit të jashtëm. Këto raporte shërbejnë si pasqyrë analitike e sistemit të arsimit të lartë në Shqipëri dhe si mjet orientues për përmirësimin e politikave, forcimin e instrumenteve rregullatore dhe harmonizimin e mëtejshëm me standardet evropiane.

Fokusi i këtij raporti tematik në lidhjen e programeve të studimit me tregun e punës dhe punësueshmërinë e studentëve lidhet me rëndësinë strategjike që kjo temë ka në kushtet e transformimeve të shpejta ekonomike, teknologjike dhe profesionale. Në këtë kontekst, punësueshmëria përbën një dimension thelbësor të relevancës dhe efektivitetit të programeve të studimit, si dhe të kontributit të institucioneve të arsimit të lartë në zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe ekonomik të vendit.

Analiza e kësaj teme reflekton pritshmëritë e aktorëve kryesorë të sistemit të arsimit të lartë: studentëve, institucioneve të arsimit të lartë, punëdhënësve dhe shoqërisë në tërësi. Sigurimi i cilësisë, në këtë kuptim, nuk kufizohet vetëm në dimensionin akademik, por përfshin edhe vlerësimin e mënyrës se si programet e studimit adresojnë nevojat e tregut të punës dhe përkthehen në kompetenca reale të studentëve.

Raporti synon të ofrojë një vlerësim të strukturuar, të bazuar në analizën e raporteve të vlerësimit të jashtëm, mbi mënyrën se si institucionet e arsimit të lartë lidhin programet e studimit me tregun e punës. Në mënyrë të veçantë, ai analizon mekanizmat e përfshirjes së aktorëve të jashtëm, praktikën profesionale, kompetencat e studentëve, punësimin dhe gjurmimin e të diplomuarve, si dhe aktivitetet mbështetëse për karrierën dhe punësueshmërinë, duke evidentuar si problematikat e përsëritura, ashtu edhe praktikat pozitive të transferueshme.

Nëpërmjet kësaj analize, ASCAL synon të mbështesë institucionet e arsimit të lartë në identifikimin e nevojave për përmirësim dhe në forcimin e kapaciteteve për planifikim kurrikular, monitorim të rezultateve dhe bashkëpunim të qëndrueshëm me aktorët e jashtëm, në funksion të një arsimit të lartë më cilësor, më relevant dhe më të orientuar drejt zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

1.2. Metodologjia

Ky raport tematik është hartuar mbi bazën e një qasjeje metodologjike të strukturuar, të orientuar drejt analizës së evidencave të gjeneruara nga proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë, në përputhje me rolin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) si autoritet përgjegjës për sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë. Metodologjia synon të garantojë objektivitet, koherencë dhe krahasueshmëri të gjetjeve, në përputhje me parimet e transparencës, pavarësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm, si dhe me Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë (ESG).

Burimi kryesor i të dhënave janë raportet e vlerësimit të jashtëm të programeve të studimit, të hartuara dhe publikuara nga ASCAL gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025. Këto dokumente zyrtare, të bazuara në vlerësimin e pavarur të ekspertëve të jashtëm, përbëjnë bazën e analizës së këtij raporti dhe sigurojnë mbështetje në evidenca të verifikuara.

Raportet janë analizuar në mënyrë tematike dhe krahasuese, me fokus në lidhjen e programeve të studimit me tregun e punës dhe punësueshmërinë e studentëve. Analiza është përqendruar në identifikimin e kërkesave të tregut të punës, praktikën profesionale, zhvillimin e kompetencave të studentëve, punësimin dhe gjurmimin e të diplomuarve, si dhe përputhshmërinë e programeve me nevojat në ndryshim të tregut të punës. Gjithashtu, është ndjekur një qasje krahasuese ndërmjet fushave të studimit dhe ndërmjet institucioneve publike dhe jopublike, me qëllim identifikimin e modeleve, praktikave efektive dhe problematikave me karakter sistematik.

Metodologjia mbështetet në parimin e triangulimit analitik, duke kombinuar analizën përshkruese me interpretimin kritik të gjetjeve në raport me standardet e sigurimit të cilësisë, kuadrin rregullator dhe zhvillimet bashkëkohore në arsimin e lartë. Analiza ruan karakterin institucional, jo-sanksionues dhe zhvillimor, duke synuar identifikimin e tendencave dhe çështjeve strukturore, dhe jo vlerësimin e performancës individuale të institucioneve apo programeve të veçanta. Gjetjet nuk duhet të interpretohen si vlerësim i drejtpërdrejtë i asnjë IAL-je, por si prirje të evidentuara në kampionin e raporteve që janë marrë në analizë.

Në këtë mënyrë, metodologjia siguron një bazë të qëndrueshme për formulimin e përfundimeve dhe rekomandimeve të raportit, duke mbështetur institucionet e arsimit të lartë në përmirësimin e praktikave të tyre dhe në forcimin e një qasjeje të bazuar në evidencë ndaj sigurimit të cilësisë dhe relevancës së programeve të studimit ndaj nevojave të tregut të punës dhe shoqërisë.

1.3.Kuadri i përgjithshëm i të dhënave të analizuara

Raporti tematik është ndërtuar mbi bazën e analizës së një grupi të gjerë dhe përfaqësues programesh studimi, raportet e vlerësimit të jashtëm të të cilave janë përfunduar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025 dhe janë publikuar gjithashtu edhe në faqen zyrtare të internetit. Në total, në kuadër të këtij raporti janë analizuar raportet e vlerësimit të jashtëm për **67 programe studimi**, të cilat përfaqësojnë një gamë të larmishme institucionesh të arsimit të lartë, fushash studimi, ciklesh studimi dhe llojesh akreditimi. Ky volum dhe diversitet i të dhënave siguron një bazë të qëndrueshme dhe të besueshme për identifikimin e tendencave, gjetjeve të përsëritura dhe problematikave strukturore që lidhen me përputhshmërinë e programeve të studimit me tregun e punës dhe punësueshmërinë e studentëve. Analiza është hartuar mbi bazën e një qasjeje të strukturuar të ndarë në këto drejtime kryesore:

- ✚ Sipas organizimit ligjor të institucionit;
- ✚ Sipas fushave të studimit;
- ✚ Sipas ciklit dhe llojit të programit;
- ✚ Sipas llojit të akreditimit.

Përsa i përket ndarjes sipas **organizimit ligjor të institucionit**, programet e analizuar ofrohen nga të dy kategoritë e institucioneve të arsimit të lartë, publike dhe jopublike. Konkretisht, 31 programe të analizuar ofrohen nga institucione publike dhe 36 programe nga institucione të arsimit të lartë jopublike. Kjo shpërndarje tregon një balancë relative ndërmjet dy kategorive të institucioneve dhe ka mundësuar realizimin e një analize krahasuese mbi qasjet ndaj tregut të punës dhe punësueshmërisë, duke reflektuar dallimet strukturore, organizative dhe funksionale që karakterizojnë secilën kategori institucioni.




Figura 1: Ndarja sipas organizimit ligjor të institucionit

Në aspektin e ndarjes sipas **fushave të studimit**, të dhënat tregojnë një përqendrim të konsiderueshëm të programeve në fushat me kërkesë të lartë shoqërore dhe profesionale. Shkencat Humane dhe Shoqërore përbëjnë grupin më të madh me 18 programe, të ndjekura nga Shkencat Ekonomike dhe Shkencat Mjekësore, secila me nga 15 programe. Shkencat Inxhinierike dhe Shkencat Filologjike dhe të Edukimit përfaqësohen respektivisht me nga 7 programe, ndërsa Shkencat Bujqësore me 2 programe. Fusha të tjera, si Arte dhe Sporte, Shkencat Ushtarake dhe Policore dhe Shkencat Natyrore, përfaqësohen secila me nga 1 program. Kjo shpërndarje krijon mundësi për analizimin e lidhjes së programeve me tregun e punës në kontekste të ndryshme disiplinore.




Figura 2: Ndarja sipas fushave të studimit

Në lidhje me ndarjen sipas **ciklit dhe llojit të programit**, programet e ciklit të parë “Bachelor” përbëjnë pjesën më të madhe të programeve të analizuar, me gjithsej 26 programe, ndjekur në vijim nga programet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” me 18 programe dhe “Master Profesional” me 14 programe. Gjithashtu, në analizë janë përfshirë 4 programe studimi me karakter profesional, 4 programe të ciklit të tretë “Studime Specializuese Afatgjata” dhe 1 program i integruar studimi i ciklit të dytë “Master i Shkencave”. Kjo shpërndarje i jep raportit një pamje të plotë të diversitetit të formave të ofrimit të arsimit të lartë dhe mundëson analizimin e punësueshmërisë në funksion të niveleve dhe profileve të ndryshme të kualifikimit.




Figura 3: Ndarja sipas ciklit dhe llojit të programit

Përsa i përket **llojit të akreditimit**, pjesa më e madhe e programeve të përfshira në analizë janë programe që kanë kaluar procesin e akreditimit për herë të parë, konkretisht 50 programe, ndërsa 17 programe janë vlerësuar në kuadër të akreditimit periodik. Kjo ndarje ka krijuar mundësi për vëzhgimin e dallimeve ndërmjet programeve në fazën e konsolidimit fillestar dhe atyre me eksperiencë të mëparshme akreditimi, veçanërisht në mënyrën se si konceptohet, zbatohet dhe dokumentohet lidhja me tregun e punës dhe punësueshmëria e studentëve.




Figura 4: Ndarja sipas llojit të akreditimit

Në tërësi, të dhënat e përdorura për hartimin e këtij raporti tematik përbëjnë një kampion të gjerë, të balancuar dhe metodologjikisht të qëndrueshëm, i cili mundëson një analizë të thelluar dhe gjithëpërfshirëse të çështjeve që lidhen me tregun e punës në arsimin e lartë. Ky konfigurim i të dhënave i jep raportit vlerë të shtuar analitike dhe e bën atë një instrument të rëndësishëm referues për institucionet e arsimit të lartë, për politikëbërësit dhe për aktorët e tjerë të interesuar në zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë dhe relevancës së programeve të studimit në Shqipëri.

2. ANALIZA TEMATIKE E GJETJEVE

2.1. Kërkesat e tregut të punës dhe mekanizmat e përfshirjes së aktorëve të jashtëm

Analiza e kërkesave të tregut të punës, për fusha dhe profile të ndryshme studimi, tregon se institucionet e arsimit të lartë janë të ndërgjegjshme për rëndësinë e përputhshmërisë së programeve të studimit me nevojat e tregut dhe përpiqen të argumentojnë relevancën e tyre. Megjithatë, niveli i thellësisë analitike, formalizimit dhe dokumentimit të këtij argumentimi ndryshon ndjeshëm ndërmjet programeve dhe institucioneve.

Në shumicën e rasteve, lidhja me tregun e punës argumentohet kryesisht në mënyrë cilësore, përmes bashkëpunimeve, marrëveshjeve dhe praktikave profesionale, duke reflektuar një angazhim të vazhdueshëm të institucioneve me realitetin e tregut. Megjithatë, ekziston hapësirë për forcimin e mëtejshëm të kësaj lidhjeje përmes mbështetjes më sistematike në studime të strukturuar të tregut të punës. Analiza tregon se programet e lidhura me sektorë të qartë profesionalë dhe me kërkesë të dukshme në treg, si inxhinieria, ndërtimi, infrastruktura, farmacia industriale apo disa profile të shërbimeve sociale, paraqesin një argumentim më të konsoliduar, me identifikim më të saktë të profileve profesionale dhe reflektim më të mirë të tendencave sektoriale në kurrikulë. Ndërkohë, në fusha më të përgjithshme akademike, si mësuesia dhe disa degë të shkencave sociale, argumentimi i kërkesës së tregut mbështetet më shumë në përvoja dhe praktika tradicionale, çka sugjeron mundësi për thellimin e analizave të ofertës dhe kërkesës. Në disa raste përmenden studime të tregut të punës, të cilat përbëjnë një bazë të vlefshme, por që mund të përforcohen më tej duke u orientuar më specifikisht drejt profileve të programeve dhe duke u integruar më qartë në proceset e planifikimit dhe rishikimit kurrikular.

Një aspekt që mund të zhvillohet më tej lidhet me krijimin e një qasjeje më të unifikuar metodologjike për analizën e tregut të punës dhe përfshirjen e aktorëve të jashtëm. Edhe pse ekzistojnë forma të ndryshme bashkëpunimi, forcimi i tyre përmes dokumentimit analitik, me indikatorë të qartë dhe përfundime të lidhura drejtpërdrejt me zhvillimin e programeve, do të rriste më tej ndikimin e tyre.

Përfshirja e aktorëve të jashtëm dhe punëdhënësve vlerësohet gjerësisht si element kyç nga institucionet dhe reflektohet në aktivitete të ndryshme, si praktikat profesionale, aktivitetet e përbashkëta dhe krijimi i kontakteve me tregun e punës. Një hap i mëtejshëm do të ishte integrimi më i strukturuar i këtij bashkëpunimi në proceset e projektimit dhe rishikimit kurrikular, në mënyrë që kontributi i tyre të reflektohet edhe më drejtpërdrejt në përmbajtjen akademike.

Në disa programe evidentohet një përfshirje më e avancuar e aktorëve të jashtëm në konsultimet për hapjen ose rishikimin e programeve dhe në identifikimin e kompetencave të nevojshme për tregun e punës, duke përfaqësuar praktika shumë pozitive të bashkëkrijimit të ofertës akademike. Forcimi i dokumentimit të ndikimit

konkret të këtij kontributi në ndryshimet kurrikulare dhe në vendimmarrjen akademike do të ndihmonte në konsolidimin dhe përhapjen e këtyre praktikave të mira.

Një aspekt që haset shpesh lidhet me mungesën e evidencës së formalizuar për përfshirjen e aktorëve të jashtëm, çka e bën më të vështirë vlerësimin e plotë të efektivitetit të bashkëpunimit dhe kufizon pasqyrimin e tij në mënyrë të strukturuar. Megjithatë, një pikë e fortë e qartë në këtë komponent është se pothuajse të gjitha programet synojnë përgatitjen e të diplomuarve për role konkrete profesionale dhe kanë zhvilluar forma bashkëpunimi me tregun e punës, duke krijuar potencial të mirë për praktikë profesionale, punësueshmëri dhe marrje të feedback-ut të jashtëm. Në disa raste, programet janë konceptuar edhe si përgjigje ndaj boshllëqeve specifike në treg, çka reflekton një kuptim të mirë të dinamikave të kërkesës dhe ofertës së punës

Në tërësi, analiza tregon se përputhshmëria me tregun e punës është e pranishme si në nivel konceptual, ashtu edhe praktik. Ekziston hapësirë për ta forcuar më tej këtë përputhshmëri në nivel strategjik dhe dokumentar, përmes një qasjeje më të strukturuar dhe të mbështetur në të dhëna, të integruar në mënyrë të qëndrueshme në ciklin e zhvillimit të programeve të studimit, me synim rritjen e mëtejshme të punësueshmërisë së të diplomuarve

2.2.Praktika profesionale dhe lidhja me tregun e punës

Në raportet e analizuara, praktika profesionale paraqitet pothuajse në të gjitha programet si mekanizmi kryesor për realizimin e lidhjes konkrete me tregun e punës dhe si një nga instrumentet më të drejtpërdrejta për përgatitjen e studentëve për punësim. Kjo dëshmon një orientim të qartë të programeve drejt dimensionit praktik dhe punësueshmërisë. Në të njëjtën kohë, evidentohet se ekziston potencial për ta zhvilluar më tej këtë komponent, duke e forcuar kalimin nga ekzistenca formale e praktikës drejt funksionimit të saj si një proces më i strukturuar, i monitoruar dhe i integruar ngushtë me arritjen e rezultateve të të nxënit dhe të punësueshmërisë.

Analiza e praktikës profesionale tregon se ajo përbën mekanizmin kryesor të lidhjes së programeve të studimit me tregun e punës dhe një nga komponentët më të konsoliduar të ndërveprimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe mjedisit profesional. Në raportet e analizuara, evidentohet se praktika profesionale është e përfshirë pothuajse në të gjitha programet si pjesë e detyrueshme e kurrikulës dhe realizohet përmes bashkëpunimeve me institucione publike, private dhe struktura profesionale, duke krijuar mundësi reale për ekspozim në mjedisin e punës, si dhe zhvillimin e aftësive praktike e forcimin e kompetencave të transferueshme.

Në të njëjtën kohë, analiza sugjeron se ekziston potencial për ta pasuruar më tej këtë komponent, duke kaluar nga një fokus kryesisht në ekzistencën e marrëveshjeve dhe numrin e institucioneve pritëse, drejt një vlerësimi më të thelluar të cilësisë së përmbajtjes së praktikës, standardizimit të procesit dhe ndikimit të saj në formimin profesional të studentëve. Në një pjesë të rasteve, vihet re hapësirë për të forcuar lidhjen ndërmjet praktikës profesionale, objektivave të programit dhe rezultateve të të nxënit, si edhe për të siguruar një konsistencë më të madhe të përvojës së praktikës ndërmjet grupeve të ndryshme studentësh dhe institucioneve pritëse. Në këtë kuadër, praktika profesionale vlerësohet gjerësisht si një element shumë pozitiv dhe me vlerë, ndërkohë që një strukturim më i thelluar do të mundësonte që ajo të jetë edhe më e krahasueshme dhe e verifikueshme në aspektin e rezultateve.

Megjithatë, analiza eidenton një dallim të dobishëm ndërmjet ekzistencës formale të praktikës dhe funksionimit të saj si një proces i mirëstrukturuar, i monitoruar dhe i integruar ngushtë me arritjen e rezultateve të të nxënit dhe punësueshmërinë. Ky dallim sugjeron mundësi konkrete për zhvillim të mëtejshëm, përmes forcimit të mekanizmave të lidhjes, ndjekjes dhe vlerësimit të praktikës, në mënyrë që ajo të kontribuojë në mënyrë edhe më të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së programeve të studimit.

Një gjetje e përsëritur është se praktika profesionale shërben shpesh si mjeti kryesor, dhe në disa raste i vetmi, për ndërtimin e lidhjes me tregun e punës, duke luajtur një rol kompensues në mungesë të mekanizmave të tjerë më të avancuar të ndërveprimit, si projekte të përbashkëta, angazhimi i profesionistëve të fushës në mësimdhënie, mentorimi i strukturuar apo bashkëkrijimi i kurrikulës. Në disa programe, kjo lidhje mbetet e përqendruar pothuajse ekskluzivisht në ofrimin e praktikave, pa u shoqëruar me mbledhje dhe analizë të rregullt të feedback-ut nga institucionet pritëse dhe pa reflektim të dokumentuar të këtij feedback-u në rishikimin dhe përmirësimin e programit.

Nga ana tjetër, raportet eidentojnë edhe praktika pozitive, ku praktika profesionale është e organizuar në mënyrë të qartë, e mbikëqyrur nga mentorë akademikë dhe profesionalë, e lidhur me kompetencat që synohen të zhvillohen dhe e shoqëruar me objektiva të përcaktuara, vlerësim dhe feedback të strukturuar. Këto modele tregojnë se, kur praktika menaxhohet në mënyrë sistematike dhe të integruar, ajo kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e punësueshmërisë së studentëve.

Analiza eidenton se ekziston hapësirë për zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave të standardizuar për monitorimin dhe vlerësimin e praktikës profesionale, si edhe për përmirësimin e mbledhjes së të dhënave të strukturuar mbi rezultatet, kënaqësinë e palëve dhe ndikimin në punësimin pas diplomimit. Dokumentimi i procesit paraqitet në disa raste i fragmentuar, çka kufizon shfrytëzimin e plotë të praktikës si burim i vlefshëm evidence për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve. Forcimi i këtyre elementeve do të mundësonte një përdorim më sistematik të informacionit të

gjeneruar nga praktika profesionale, duke kontribuar në mënyrë më të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë dhe relevancës së programeve të studimit.

Si rrjedhojë, lidhja me tregun e punës, ndonëse aktive dhe funksionale në nivel praktik, paraqet potencial për t'u zhvilluar më tej drejt partneriteteve më të qëndrueshme dhe strategjike afatgjata, të cilat mund të kontribuojnë në mënyrë edhe më të drejtpërdrejtë në përditësimin e kurrikulave dhe në forcimin e ciklit të sigurimit të cilësisë.

Në tërësi, praktika profesionale përbën një pikë të fortë të programeve të studimit dhe një bazë të rëndësishme për ndërveprimin me tregun e punës. Megjithatë, një qasje më e integruar, e standardizuar dhe e mbështetur në evidencë do të ndihmonte në rritjen e mëtejshme të ndikimit të saj në cilësinë e programeve dhe në punësueshmërinë e studentëve.

2.3.Kompetencat dhe aftësitë e studentëve në raport me kërkesat e tregut të punës

Analiza e kompetencave dhe aftësive që studentët përfitojnë përmes programeve të studimit tregon se ky dimension konsiderohet gjerësisht nga institucionet e arsimit të lartë si një element i rëndësishëm në konceptimin dhe justifikimin e programeve, veçanërisht në raport me kërkesat e tregut të punës. Megjithatë, nga shqyrtimi i raporteve evidentohet se zhvillimi i kompetencave nuk paraqitet gjithmonë si një rezultat i matshëm dhe i vlerësuar në mënyrë të strukturuar. Programet zakonisht përfshijnë lista të gjera kompetencash profesionale, njohurish dhe aftësish të transferueshme që synohet të përvetësohen nga studentët, por në disa raste vihet re një lidhje jo plotësisht e drejtpërdrejtë ndërmjet këtyre kompetencave të deklaruara dhe evidencave konkrete të arritjes së tyre.

Programet zakonisht përshkruajnë kompetenca profesionale dhe aftësi të transferueshme në përputhje me kornizat formale të kualifikimeve, por megjithatë, në disa raste vërehet se lidhja ndërmjet këtyre objektivave, rezultateve të të nxënit dhe instrumenteve të vlerësimit nuk paraqitet plotësisht e qartë. Për rrjedhojë, kompetencat priren të trajtohen më shumë si synime të përgjithshme sesa si rezultate të mirëpërcaktuara dhe të verifikueshme të procesit mësimor.

Analiza sugjeron se kompetencat profesionale në programet e studimit lidhen kryesisht me përmbajtjen e lëndëve dhe strukturën formale të kurrikulës, ndërkohë që ndërlidhja e tyre me rezultatet e të nxënit dhe metodat e vlerësimit mund të forcohet më tej. Programet shpesh përshkruajnë aftësitë që studentët priten të përvetësojnë pas diplomimit, por jo gjithmonë shpjegojnë në mënyrë të detajuar mekanizmat pedagogjikë dhe vlerësues përmes të cilëve këto aftësi zhvillohen, maten dhe

konsolidohen gjatë ciklit të studimit. Kjo mund të krijojë një mospërputhje të lehtë ndërmjet konceptimit formal të programit dhe përvojës së të nxënit, duke e bërë më sfiduese vlerësimin e plotë të efektivitetit të programeve në zhvillimin e kompetencave të kërkuara nga tregu i punës.

Aftësitë e transferueshme dhe ndërdisiplinore njihen gjerësisht, në nivel deklarativ, si elemente të rëndësishme për rritjen e punësueshmërisë së studentëve, por jo gjithmonë trajtohen në mënyrë të strukturuar dhe të matshme. Kompetenca si komunikimi profesional, përdorimi i teknologjive digjitale, puna në mjedise shumëdisiplinore, aftësitë analitike dhe përshtatshmëria përmenden shpesh në dokumentacionin programor dhe në raportet e vlerësimit, por jo gjithmonë shoqërohen me indikatorë të qartë që të dëshmojnë nivelin e përvetësimit të tyre nga studentët..

Nga ana tjetër, raportet evidentojnë edhe praktika pozitive, veçanërisht në programe ku kompetencat janë të lidhura qartë me profile profesionale konkrete dhe me kërkesa specifike të tregut të punës. Në këto raste, zhvillimi i aftësive praktike mbështetet përmes laboratorëve, projekteve të aplikuara, praktikave profesionale dhe punës në terren, duke krijuar mundësi për ndërveprim të drejtpërdrejtë me situata reale ose të simuluar profesionale. Këto modele tregojnë se, kur kompetencat integrohen në mënyrë koherente në kurrikulë dhe në procesin e të nxënit, ato kontribuojnë drejtpërdrejt në përgatitjen më të mirë të studentëve për tregun e punës.

Megjithatë, një çështje që shfaqet në mënyrë të vazhdueshme lidhet me nevojën për forcimin e mekanizmave të konsoliduar për vlerësimin e kompetencave në nivel programi. Raportet fokusohen kryesisht në vlerësimin e njohurive përmes formave tradicionale të testimit, ndërsa vlerësimi i aftësive praktike, kompetencave profesionale dhe aftësive të transferueshme paraqitet në disa raste më i kufizuar ose më pak i strukturuar. Kjo sugjeron se, ndonëse kompetencat janë të reflektuara në diskursin institucional dhe në dokumentet programore, integrimi i tyre në sistemin e vlerësimit të studentëve mund të zhvillohet më tej.

Në përfundim, analiza tregon se institucionet e arsimit të lartë kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt orientimit të programeve të studimit në funksion të zhvillimit të kompetencave dhe aftësive të kërkuara nga tregu i punës, megjithatë këto përpjekje në disa raste mbeten kryesisht në nivel konceptual, duke evidentuar nevojën për mekanizma më të qartë dhe të qëndrueshëm për matjen dhe vlerësimin e arritjes së tyre. Një drejtim i mëtejshëm zhvillimi lidhet me ndërtimin e një qasjeje më të integruar dhe të bazuar në evidencë, ku kompetencat të ndërlidhen në mënyrë koherente me rezultatet e të nxënit, proceset mësimore dhe instrumentet e vlerësimit, si tregues të matshëm dhe të besueshëm të cilësisë dhe relevancës së programeve.

2.4.Punësimi dhe gjurmimi i të diplomuarve

Analiza e punësimit të studentëve dhe të diplomuarve tregon se ky dimension trajtohet nga institucionet e arsimit të lartë si një element i rëndësishëm për vlerësimin e efektivitetit të programeve të studimit, por ende jo gjithmonë si një instrument i mirëfilltë analitik për matjen e ndikimit real të tyre në tregun e punës. Në raportet e analizuara, punësimi argumentohet kryesisht në mënyrë përshkruese, duke u mbështetur më shumë në perceptime dhe potenciale të pritshme sesa në të dhëna të strukturuar, të verifikueshme dhe të gjurmuar në mënyrë të vazhdueshme.

Në shumicën e programeve, punësimi përshkruhet si i mundshëm ose i pritshëm, veçanërisht në fusha me orientim të qartë profesional. Kjo qasje është veçanërisht e pranishme në programe që lidhen me profesione të rregulluara ose me sektorë tradicionalisht absorbues të forcës punëtore, ku supozohet ekzistenca e një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet diplomës dhe punësimit. Megjithatë, raportet rrallëherë ofrojnë të dhëna konkrete mbi nivelin real të punësimit, kohën e integritimit në treg, sektorët e punësimit apo përputhshmërinë ndërmjet profilit të studimit dhe punësimit.

Një gjetje e përsëritur lidhet me faktin se institucionet mbështeten kryesisht në praktikat profesionale, marrëveshjet e bashkëpunimit dhe kontaktet informale me punëdhënësit si tregues indirektë të punësimit të studentëve. Praktika profesionale vlerësohet gjerësisht si një mekanizëm pozitiv, që krijon ura lidhëse me tregun e punës dhe rrit potencialin për punësim pas diplomimit. Megjithatë, në raportet e analizuara mungon shpesh analiza se në ç'masë këto praktika përkthehen realisht në punësim dhe, më gjerë, mungon një gjurmim i strukturuar dhe i vazhdueshëm i rrugëtimit profesional të studentëve dhe të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Në disa programe evidentohet përpjekja për të mbledhur informacion mbi punësimin e të diplomuarve përmes kontakteve me alumni, anketimeve të rastësishme ose vlerësimeve të përgjithshme të stafit akademik. Këto iniciativa përbëjnë hapa pozitivë drejt ndërtimit të një kulture monitorimi të rezultateve, por zakonisht janë të fragmentuara, jo periodike dhe jo të standardizuara. Si rrjedhojë, gjurmimi i të diplomuarve nuk shndërrohet në një mekanizëm të qëndrueshëm institucional dhe të dhënat e mbledhura nuk përdoren sistematikisht si tregues performance për programet e studimit apo si bazë për rishikime kurrikulare.

Analiza tregon gjithashtu se, në një pjesë të konsiderueshme të programeve, punësimi argumentohet më shumë në terma potenciali sesa rezultati real. Programet përshkruajnë fushat e mundshme të punësimit, pozicionet profesionale dhe kompetencat që synohen, por pa e lidhur këtë përshkrim me të dhëna empirike mbi atë që realisht ndodh pas diplomimit. Kjo krijon një diferencë të qartë ndërmjet konceptimit të programit dhe vlerësimit të ndikimit të tij real në tregun e punës.

Pikat e forta të këtij komponenti lidhen me orientimin e qartë profesional të shumicës së programeve dhe me përgatitjen e studentëve për role konkrete në tregun e punës, të mbështetur nga praktika të detyrueshme, projekte të lidhura me realitetin profesional dhe bashkëpunime me institucione pritëse. Këta elementë përbëjnë një bazë të rëndësishme për rritjen e punësueshmërisë, nëse shoqërohen me mekanizma të strukturuar monitorimi dhe analize.

Megjithatë, analiza eidenton mungesën e mekanizmave të qëndrueshëm për gjurmimin e studentëve dhe të diplomuarve. Konsolidimi i anketimeve të standardizuara, databazave alumni dhe analizave të përputhshmërisë ndërmjet profilit të studimit dhe punësimit mbetet thelbësor për ta shndërruar punësimin në tregues të matshëm të cilësisë dhe efektivitetit të programeve.

Në përfundim, analiza tregon se institucionet e arsimit të lartë kanë një orientim të qartë drejt punësueshmërisë së studentëve, por ende nuk e kanë konsoliduar këtë orientim në një sistem të strukturuar dhe të integruar monitorimi të punësimit dhe gjurmimit të të diplomuarve. Sfida kryesore që del nga raportet e analizuara është ndërtimi i një sistemi institucional të qëndrueshëm për gjurmimin e rezultateve të punësimit, i cili të shërbejë jo vetëm për raportim formal, por edhe si instrument real për rishikimin e programeve të studimit, përmirësimin e praktikave mësimore dhe forcimin e lidhjes efektive ndërmjet arsimit të lartë dhe tregut të punës.

2.5. Aktivitetet mbështetëse për karrierën dhe punësueshmërinë

Analiza e komponentit që lidhet me aktivitetet e realizuara në mbështetje të studentëve tregon se ky dimension trajtohet nga institucionet e arsimit të lartë si një element i rëndësishëm mbështetës i procesit mësimor dhe i përgatitjes së studentëve për integrimin në tregun e punës. Megjithatë, në disa raste vërehet se këto aktivitete nuk paraqiten ende si pjesë e një mekanizmi plotësisht të strukturuar, të planifikuar dhe të vlerësuar në mënyrë sistematike. Nga shqyrtimi i raporteve eidentohet se institucionet ofrojnë një gamë relativisht të gjerë aktiviteteve në mbështetje të studentëve, por këto aktivitete paraqiten kryesisht në mënyrë përshkruese dhe më pak të integruara në një kuadër analitik që do të mundësonte vlerësimin më të plotë të ndikimit të tyre në përvojën akademike dhe profesionale të studentëve.

Në shumicën e rasteve, aktivitetet në mbështetje të studentëve përfshijnë orientimin akademik, këshillimin individual dhe në grup, mbështetjen gjatë zhvillimit të praktikave profesionale, informimin mbi mundësitë e punësimit, si dhe organizimin e aktiviteteve trajnuese ose informuese me aktorë të tregut të punës. Këto iniciativa dëshmojnë përpjekjet e institucioneve për të krijuar kushte më të favorshme për zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve. Megjithatë, në disa raste vërehet se raportet nuk ofrojnë informacion të mjaftueshëm mbi aksesueshmërinë e këtyre

aktiviteteve, shkallën e përfshirjes së studentëve dhe përshtatshmërinë e tyre ndaj nevojave të grupeve të ndryshme studentore.

Analiza sugjeron se mbështetja e studentëve argumentohet kryesisht përmes ekzistencës së strukturave formale, si zyrat e karrierës ose këshillimit, ndërkohë që të dhënat mbi funksionimin dhe rezultatet konkrete të tyre paraqiten më të kufizuara. Në disa raste mungojnë informacione mbi shtrirjen e shërbimeve, nivelin e përfshirjes së studentëve dhe ndikimin e aktiviteteve, çka e bën këtë dimension të shfaqet më shumë si një kapacitet i konsoliduar në nivel strukturor, me potencial për t'u zhvilluar më tej drejt një qasjeje më aktive dhe të monitoruar.

Një gjetje e përsëritur lidhet me faktin se aktivitetet në mbështetje të studentëve zhvillohen në disa raste në mënyrë të fragmentuar, më tepër si përgjigje ndaj nevojave imediate sesa si pjesë e një qasjeje plotësisht të integruar dhe afatgjatë institucionale. Kjo vihet re veçanërisht në aktivitetet që lidhen me orientimin drejt tregut të punës dhe punësueshmërinë, ku iniciativat janë të dobishme dhe të mirëpritura nga studentët, por jo gjithmonë të planifikuara në mënyrë të vazhdueshme apo të ndërlidhura qartë me objektivat strategjike të programeve të studimit.

Nga ana tjetër, evidentohen praktika pozitive, ku institucionet ofrojnë forma më të strukturuar mbështetjeje, si programe orientimi për karrierën, trajnime dhe aktivitete përgatitore për tregun e punës, të cilat kontribuojnë në rritjen e gatishmërisë së studentëve për integrim profesional.

Analiza sugjeron gjithashtu se ekziston hapësirë për forcimin e mekanizmave të qartë dhe të standardizuar për vlerësimin e ndikimit të aktiviteteve në mbështetje të studentëve. Në disa raste, raportet përfshijnë më pak indikatorë të matshëm mbi efektivitetin e tyre, si punësimi, zhvillimi i aftësive apo kënaqësia e studentëve. Si rrjedhojë, monitorimi dhe përmirësimi i këtyre aktiviteteve mund të përfitojë nga një qasje më sistematike dhe e bazuar në evidencë.

Në përfundim, analiza tregon se institucionet e arsimit të lartë kanë zhvilluar një sërë aktivitete në mbështetje të studentëve, të cilat përbëjnë një bazë të rëndësishme për përmirësimin e përvojës akademike dhe profesionale. Megjithatë, për të rritur më tej ndikimin e tyre, këto aktivitete mund të përfitojnë nga një integrim më i plotë në një sistem të qëndrueshëm, të strukturuar dhe të monitoruar, i ndërlidhur qartë me objektivat e programeve të studimit dhe me rezultatet e punësueshmërisë. Në këtë mënyrë, aktivitetet në mbështetje të studentëve mund të konsolidohen më tej si instrumente strategjike që kontribuojnë në rritjen e cilësisë dhe efektivitetit në raport me nevojat e tregut të punës.

3. ANALIZA KRAHASUESE E GJETJEVE

3.1. Analiza krahasuese sipas fushave të studimit

Analiza krahasuese sipas fushave të studimit evidenton dallime në nivelin dhe mënyrën e përputhshmërisë së programeve të studimit me tregun e punës.

Programet në fushat e inxhinierisë, teknologjisë dhe shëndetësisë priren të shfaqin një lidhje më të drejtpërdrejtë me tregun e punës, e mbështetur nga kërkesa relativisht e lartë për këto profile, si dhe nga prania e praktikave profesionale më të strukturuar dhe komponentëve laboratorikë të zhvilluar. Në të njëjtën kohë, programet në shkencat shoqërore dhe humanitare paraqesin në disa raste një lidhje më të tërthortë me tregun e punës, shpesh të reflektuar në mënyrë më të përgjithshme në dokumentacion. Ndërkohë, fusha e arsimit karakterizohet nga një nivel i qëndrueshëm i punësueshmërisë në tregun lokal, megjithëse evidentohet hapësirë për përmirësim në drejtim të dokumentimit dhe gjurmimit më sistematik të të dhënave mbi punësimin.

Analiza e integruar e komponentëve që lidhen me tregun e punës – përfshirë punësimin, praktikën profesionale, kompetencat, përputhshmërinë e programeve, aktivitetet mbështetëse për studentët dhe përfshirjen e aktorëve të jashtëm – sugjeron se mënyra se si këto dimensione konceptohen dhe funksionojnë ndryshon në mënyrë të ndjeshme ndërmjet fushave të ndryshme të studimit, duke reflektuar specifikat dhe dinamikat e secilës fushë.

Shkencat Inxhinierike

Programet në fushën e shkencave inxhinierike priren të paraqesin një nivel të lartë të përputhshmërisë së argumentuar dhe të dokumentuar me tregun e punës. Raportet tregojnë se kërkesat e tregut identifikohen në mënyrë relativisht të qartë, profilet profesionale janë të mirëpërcaktuara dhe kompetencat e synuara paraqiten konkrete, teknike dhe në një masë të konsiderueshme të matshme. Rishikimet kurrikulare lidhen ngushtë me zhvillimet sektoriale, si infrastruktura, teknologjitë e ndërtimit, inxhinieria biomjekësore dhe teknologjitë diagnostikuese, duke reflektuar një marrëdhënie funksionale ndërmjet ofertës akademike dhe kërkesës profesionale.

Punësimi i studentëve dhe i të diplomuarve evidentohet jo vetëm në nivel përshkrues, por edhe përmes shembujve konkretë të punësimit pas praktikave profesionale, veçanërisht në programet e akredituara periodikisht. Praktika profesionale shfaqet si një komponent kyç dhe në shumë raste kontribuon drejtpërdrejt në integrimin në tregun e punës. Megjithatë, edhe në këtë fushë vihet re se raportimi statistikor i standardizuar mbi punësimin mund të zhvillohet më tej, duke e bërë analizën aktuale të mbështetur kryesisht në evidenca cilësore.

Kompetencat teknike dhe digjitale paraqiten të zhvilluara dhe të përafuara me standardet bashkëkohore, ndërsa aktivitetet mbështetëse për studentët rezultojnë relativisht të strukturuar dhe funksionale. Një drejtim i mëtejshëm zhvillimi lidhet

me formalizimin e analizave periodike të tregut dhe ndërtimin e sistemeve të qëndrueshme për gjurmimin e punësimit.

Shkencat Filologjike dhe të Edukimit

Në fushën e shkencave filologjike dhe të edukimit, përputhshmëria e programeve me tregun e punës shfaqet e konsoliduar në nivel konceptual dhe institucional, ndërkohë që në disa raste mund të forcohet më tej në nivel analitik. Programet e mësuesisë ndërtohen kryesisht mbi nevojat e sistemit arsimor publik dhe lokal, ku tregu i punës paraqitet relativisht i rregulluar dhe i parashikueshëm. Si rrjedhojë, kërkesat e tregut trajtohen shpesh përmes konsultimeve institucionale, më shumë sesa përmes studimeve të formalizuara të tregut.

Punësimi i të diplomuarve rezulton përgjithësisht në nivele të qëndrueshme dhe kryesisht në përputhje me profilin e studimeve, megjithëse raportet nuk përfshijnë gjithmonë të dhëna statistikore të strukturuar mbi përqindjet e punësimit, kohën drejt punësimit apo lëvizshmërinë profesionale. Praktika profesionale është e mirëintegruar në programet e studimit, ndërsa një hapësirë për zhvillim lidhet me standardizimin e mëtejshëm të dokumentacionit dhe të vlerësimit ndërmjet institucioneve pritëse.

Kompetencat pedagogjike paraqiten të qarta dhe në përputhje me kornizat përkatëse kombëtare, ndërkohë që identifikohen nevoja të vazhdueshme për forcimin e kompetencave digjitale, përmirësimin e aftësive në gjuhë të huaja dhe përditësimin e vazhdueshëm të literaturës. Aktivitetet mbështetëse për studentët ekzistojnë, por në disa raste funksionojnë më shumë si iniciativa të veçuara, duke lënë hapësirë për zhvillimin e tyre si pjesë e një sistemi më të integruar në funksion të punësueshmërisë.

Shkencat Bujqësore

Programet në shkencat bujqësore paraqesin një lidhje të natyrshme me tregun e punës, për shkak të rolit të drejtpërdrejtë që ky sektor ka në zhvillimin ekonomik dhe rajonal. Raportet pasqyrojnë një ndërgjegjësim të qartë për nevojat e tregut dhe për rëndësinë e dimensionit praktik të programeve, megjithatë ky orientim në disa raste nuk shoqërohet plotësisht me instrumente analitike të strukturuar.

Kërkesat e tregut përshkruhen kryesisht në terma lokalë dhe të përgjithshëm, ndërsa evidencat mbi punësimin paraqiten më shpesh në mënyrë indirekte. Praktika profesionale është e pranishme në programet e studimit, por në disa raste mund të forcohet në drejtim të standardizimit dhe të monitorimit të ndikimit të saj në punësim.

Në tërësi, kjo fushë paraqet potencial të konsiderueshëm për forcimin e mëtejshëm të lidhjes me tregun e punës, duke përfituar nga një formalizim më i madh i proceseve dhe nga përmirësimi i dokumentimit dhe analizës së të dhënave.

Arte dhe Sporte

Në fushën e arteve dhe sporteve, marrëdhënia me tregun e punës paraqitet në disa raste më e larmishme dhe më pak lineare. Programet argumentojnë përputhshmërinë kryesisht përmes zhvillimit të kompetencave krijuese, artistike dhe fizike, si dhe përmes përfshirjes në projekte dhe aktivitete praktike. Punësimi trajtohet shpesh në terma potenciali dhe mundësish për vetëpunësim, ndërkohë që të dhënat e strukturuar mbi ndjekjen e karrierës nuk janë gjithmonë të disponueshme.

Praktika profesionale dhe përfshirja e aktorëve të jashtëm realizohen në disa raste, por jo gjithmonë në mënyrë të sistemuar apo të integruar në mekanizma të qëndrueshëm monitorimi. Aktivitetet mbështetëse për studentët janë të pranishme, megjithatë ndikimi i tyre nuk evidentohet gjithmonë në mënyrë të plotë në raportet e analizuara.

Shkencat Ushtarake dhe Policore

Programet në shkencat ushtarake dhe policore përbëjnë një rast të veçantë, ku përputhshmëria me tregun e punës është në një masë të madhe e siguruar nga vetë struktura institucionale. Kërkesat e tregut paraqiten të qarta, kompetencat janë të mirëpërcaktuara dhe praktika profesionale është e integruar në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin formues. Punësimi i të diplomuarve është në përgjithësi i parashikueshëm dhe kryesisht i garantuar, çka e redukton nevojën për analiza klasike të tregut të punës.

Megjithatë, raportet evidentojnë hapësira për zhvillim në drejtim të forcimit të mekanizmave të feedback-ut nga aktorë të jashtëm, si dhe në rritjen e fleksibilitetit për t'u përshtatur me zhvillimet teknologjike dhe organizative.

Shkencat Natyrore

Në fushën e shkencave natyrore evidentohen disa sfida në lidhjen me tregun e punës. Programet janë të orientuara kryesisht drejt formimit teorik dhe akademik, ndërsa përputhshmëria me tregun e punës argumentohet më shpesh në terma potenciali kërkimor sesa në lidhje me punësimin konkret. Studimet e tregut të punës në disa raste janë të kufizuara, ndërsa praktika profesionale nuk është gjithmonë e strukturuar apo e përfshirë në mënyrë të detyrueshme.

Punësimi i të diplomuarve nuk analizohet gjithmonë në mënyrë sistematike dhe aktivitetet mbështetëse paraqiten më të kufizuara në krahasim me disa fusha të tjera. Në këtë kuadër, vërehet hapësirë për zhvillim të mëtejshëm në drejtim të forcimit të lidhjes ndërmjet formimit akademik dhe kërkesave të tregut të punës.

3.2. Analiza krahasuese sipas organizimit ligjor të institucionit (publik/jopublik)

Analiza e gjetjeve nga raportet e vlerësimit të jashtëm evidenton se mënyra se si institucionet e arsimit të lartë konceptojnë dhe zbatojnë lidhjen e programeve të studimit me tregun e punës ndryshon në varësi të organizimit ligjor të institucionit, përkatësisht ndërmjet institucioneve publike dhe atyre jopublike. Këto dallime nuk lidhen vetëm me zgjedhje organizative, por pasqyrojnë edhe modele të ndryshme funksionimi institucional, nivele të ndryshme fleksibiliteti në raport me kërkesat e tregut, si dhe qasje të ndryshme në përdorimin e instrumenteve analitike për sigurimin e cilësisë.

Në institucionet e arsimit të lartë publike, lidhja me tregun e punës ndërtohet kryesisht mbi rolin e tyre institucional në shërbim të interesit publik dhe në funksion të sistemit të arsimit të lartë. Programet e studimit, veçanërisht në fusha si arsimi, shkencat shoqërore, shërbimet publike dhe disa profile të shëndetësisë, argumentojnë përputhshmërinë me tregun e punës duke u mbështetur në nevojat e sistemit publik, në politikat kombëtare sektoriale dhe në kërkesat e tregjeve lokale relativisht të qëndrueshme dhe të rregulluara. Kjo qasje i jep institucioneve publike një pozicion të konsoliduar në raport me punësueshmërinë brenda profileve të rregulluara, duke krijuar njëkohësisht hapësirë për zhvillimin e mëtejshëm të instrumenteve më dinamike dhe të standardizuara për analizën e tregut të punës.

Raportet e vlerësimit të jashtëm tregojnë se, në institucionet publike, kërkesa e tregut të punës argumentohet kryesisht në mënyrë cilësore, përmes referencave ndaj dokumenteve strategjike, planeve sektoriale, konsultimeve me institucione publike dhe përvojës institucionale të akumuluar ndër vite. Studimet e strukturuar dhe periodike të tregut të punës janë në disa raste të kufizuara, ndërsa analiza e kërkesës për profile specifike mbetet shpesh në nivel të përgjithshëm. Si rrjedhojë, përputhshmëria me tregun e punës paraqitet më tepër si një supozim i qëndrueshëm, sesa si rezultat i një analize të vazhdueshme të bazuar në evidencë.

Punësimi i të diplomuarve në institucionet publike rezulton përgjithësisht në nivele të kënaqshme, veçanërisht në programet që lidhen drejtpërdrejt me sektorin publik dhe tregjet e rregulluara, ku vërehet një lidhje relativisht e drejtpërdrejtë ndërmjet diplomës dhe punësimit. Megjithatë, raportet evidentojnë se jo gjithmonë këto rezultate shoqërohen me mekanizma të konsoliduar për gjurmimin sistematik të të diplomuarve. Të dhënat mbi punësimin paraqiten në disa raste të fragmentuara dhe jo të standardizuara, duke kufizuar mundësinë për analizë krahasuese ndër vite apo ndërmjet programeve.

Praktika profesionale në institucionet publike përbën një element të konsoliduar si në aspektin formal, ashtu edhe në atë organizativ. Ajo është e integruar në kurrikulë, zhvillohet në institucione publike dhe struktura të lidhura drejtpërdrejt me fushën e studimit, si dhe mbështetet nga mentorë akademikë dhe institucionalë. Megjithatë, analiza sugjeron se praktika profesionale nuk shoqërohet gjithmonë me mekanizma të standardizuar monitorimi dhe vlerësimi, ndërsa ndikimi i saj në punësimin pas diplomimit nuk evidentohet në mënyrë të plotë dhe të strukturuar. Në këtë kuptim, praktika mbetet një komponent i rëndësishëm formues, me potencial për t'u zhvilluar më tej si një instrument analitik në funksion të vlerësimit të cilësisë dhe relevancës së programeve.

Në institucionet e arsimit të lartë jopublike, qasja ndaj tregut të punës paraqitet në disa raste më e drejtpërdrejtë, më pragmatike dhe më e orientuar drejt rezultateve konkrete. Programet e studimit, veçanërisht në fusha teknike, ekonomike, inxhinierike dhe mjekësore, shfaqin një lidhje më funksionale me tregun e punës, të mbështetur në kërkesën reale për profile profesionale specifike, si dhe në bashkëpunime aktive me sektorin privat. Raportet sugjerojnë se institucionet jopublike karakterizohen nga një fleksibilitet më i madh në rishikimin e kurrikulave, në përshtatjen e përmbajtjes mësimore dhe në integrimin e praktikave profesionale, duke reflektuar në këtë mënyrë zhvillimet dhe ndryshimet dinamike të kërkesave të tregut.

Punësimi i të diplomuarve në këto IAL argumentohet kryesisht përmes rasteve konkrete, veçanërisht pas përfundimit të praktikave profesionale, çka reflekton një lidhje më të drejtpërdrejtë ndërmjet programeve të studimit dhe tregut të punës. Kjo qasje dëshmon një rol më aktiv të institucioneve në ndërtimin e partneriteteve me punëdhënësit dhe lehtësimin e kontakteve profesionale për studentët. Megjithatë, gjurmimi i punësimit mbetet kryesisht në nivel cilësor dhe ende i pa standardizuar, pasi në disa raste mungojnë sisteme të konsoliduara për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave statistikore mbi punësimin dhe trajektoret profesionale të të diplomuarve. Kjo situatë mund të kufizojë mundësitë për vlerësim krahasues, si ndërmjet institucioneve, ashtu edhe në raport me fushat e studimit.

Praktika profesionale në institucionet jopublike rezulton një nga mekanizmat më efektivë të lidhjes me tregun e punës. Ajo mbështetet në rrjete të gjera partnerësh privatë, zhvillohet në mjedise reale profesionale dhe, në disa raste, shoqërohet me mundësi konkrete punësimi. Megjithatë, analiza sugjeron se ndikimi i praktikës nuk dokumentohet gjithmonë në mënyrë analitike dhe nuk shoqërohet në të gjitha rastet me tregues të matshëm që të evidentojnë efektivitetin e saj në afatgjatë.

Në tërësi, analiza tematike krahasuese tregon se institucionet publike dhe jopublike ndjekin modele të ndryshme në lidhjen e programeve të studimit me tregun e punës, ndërkohë që përballen me disa sfida të përbashkëta në nivel analitik dhe metodologjik. Institucionet publike mund të përfitojnë nga forcimi i instrumenteve të analizës së tregut dhe nga zhvillimi i mekanizmave më sistematikë për gjurmimin e rezultateve të punësimit, ndërsa institucionet jopublike mund të konsolidojnë më tej

dokumentimin, standardizimin dhe transparencën e praktikave që aktualisht funksionojnë kryesisht në nivel operacional. Në të dyja rastet, sfida kryesore lidhet me avancimin drejt një qasjeje më të integruar dhe të bazuar në evidencë, që lidh në mënyrë koherente analizën e tregut të punës, punësimin e të diplomuarve, zhvillimin e kompetencave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, në funksion të rritjes së cilësisë dhe forcimit të rolit të arsimit të lartë në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit.

4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

4.1.Përfundime të përgjithshme

Analiza tematike e raporteve të vlerësimit të jashtëm evidenton se lidhja e programeve të studimit me tregun e punës dhe punësueshmëria e studentëve përbëjnë një nga sfidat thelbësore dhe të përbashkëta për sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri. Analiza e integruar e komponentëve kryesorë – kërkesat e tregut të punës, përfshirja e aktorëve të jashtëm, praktika profesionale, kompetencat, punësimi dhe aktivitetet mbështetëse – sugjeron se institucionet e arsimit të lartë kanë ndërmarrë përpjekje të qëndrueshme për të orientuar ofertën akademike drejt punësueshmërisë së studentëve dhe rritjes së relevancës profesionale të programeve të studimit.

Në raportet e analizuara konstatohet një ndërgjegjësim i qartë institucional se lidhja me tregun e punës përbën një element të rëndësishëm të cilësisë dhe qëndrueshmërisë së programeve të studimit. Megjithatë, analiza tregon se kjo lidhje në disa raste realizohet kryesisht në mënyrë funksionale dhe përshtetëse, ndërkohë që ka hapësirë për zhvillimin e mëtejshëm të saj si një proces më i strukturuar, analitik dhe i mbështetur në evidencë. Niveli i formalizimit, thellësia analitike dhe përdorimi sistematik i të dhënave ndryshojnë ndërmjet programeve, fushave të studimit dhe kategorive të institucioneve, duke reflektuar një gamë të larmishme qasjesh institucionale ndaj tregut të punës.

Në lidhje me analizën e kërkesave të tregut të punës dhe përfshirjen e aktorëve të jashtëm, evidentohet se këto elemente janë të pranishme dhe funksionale në praktikë, por në disa raste nuk janë ende plotësisht të konsoliduara në nivel strategjik dhe dokumentar. Përputhshmëria me tregun argumentohet kryesisht përmes elementeve përshtetëse, si praktikat profesionale, marrëveshjet e bashkëpunimit dhe konsultimet me punëdhënësit, ndërkohë që studimet e formalizuara të tregut, indikatorët e matshëm dhe analizat krahasuese në kohë mbeten më të kufizuara. Kjo krijon hapësirë për zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave që mundësojnë vlerësimin më të qëndrueshëm të ndikimit real të programeve në punësueshmërinë dhe zhvillimin profesional të të diplomuarve.

Analiza evidenton gjithashtu dallime ndërmjet fushave të studimit. Programet që lidhen me sektorë më të strukturuar dhe me kërkesë të qartë profesionale shfaqin nivele më të larta të përputhshmërisë me tregun e punës, ndërsa programet në fusha më të përgjithshme akademike, ose me treg më pak të formalizuar, mbështeten më shpesh në argumentim konceptual sesa në evidencë empirike të konsoliduar. Këto dallime reflektojnë jo vetëm specifikat akademike të fushave, por edhe shkallën e rregullimit profesional, traditën e bashkëpunimit me punëdhënësit dhe nivelin e strukturimit të tregut përkatës.

Praktika profesionale rezulton si një nga komponentët më të konsoliduar të lidhjes me tregun e punës dhe përbën një pikë të fortë të pjesës më të madhe të programeve të studimit. Ajo është e përfshirë në planet mësimore të pothuajse të gjitha programeve

të analizuar dhe mbështetet nga një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione publike dhe private. Megjithatë, në disa raste, mungesa e standardizimit, e monitorimit të strukturuar dhe e dokumentimit të rezultateve kufizon potencialin e praktikës profesionale për t'u shndërruar në një instrument analitik për përmirësimin e programeve dhe për matjen e ndikimit të saj në punësueshmëri.

Në lidhje me kompetencat dhe aftësitë e studentëve, analiza tregon se programet paraqesin lista të gjera kompetencash profesionale dhe të transferueshme që synohen të përvetësohen nga studentët, megjithatë këto nuk lidhen gjithmonë në mënyrë të drejtpërdrejtë me rezultatet e të nxënit, metodat e mësimdhënies dhe instrumentet e vlerësimit. Në veçanti, evidentohet nevoja për forcimin e mëtejshëm të kompetencave digjitale, të aftësive në gjuhë të huaja dhe të aftësive ndërdisiplinore, të cilat janë gjithnjë e më të rëndësishme në raport me kërkesat e tregut të punës.

Punësimi i studentëve dhe i të diplomuarve trajtohet në shumicën e programeve më shumë si një pritshmëri e arsyeshme sesa si rezultat i dokumentuar dhe i gjurmuar në mënyrë sistematike. Edhe pse shumë programe paraqesin potencial të mirë punësimi dhe, në disa raste, tregues pozitivë të integritit në tregun e punës brenda profilit, shpesh mungojnë të dhëna statistikore të strukturuar mbi nivelin e punësimit, kohën e integritit, sektorët e punësimit dhe përputhshmërinë me profilin e studimit. Gjurmimi i të diplomuarve ekziston, por jo gjithmonë në forma formale, periodike dhe të standardizuara, çka kufizon përdorimin e këtyre të dhënave për qëllime analitike dhe përmirësuese.

Analiza e aktiviteteve mbështetëse për studentët tregon se institucionet ofrojnë një gamë shërbimesh dhe iniciativash në funksion të punësueshmërisë, si këshillim karriere, informim për praktika dhe punësim, takime me alumni dhe aktivitete profesionale. Megjithatë, këto aktivitete në disa raste zhvillohen në mënyrë të fragmentuar dhe jo gjithmonë si pjesë e një strategjie të integruar institucionale. Mungesa e indikatorëve për matjen e ndikimit të tyre real e kufizon rolin e këtyre aktiviteteve si instrumente të plotë të sigurimit të cilësisë.

Në tërësi, analiza evidenton se sistemi i arsimit të lartë në Shqipëri ka ndërtuar mekanizma funksionale për lidhjen me tregun e punës, por këta mekanizma ende nuk janë konsoliduar në një sistem të integruar, të standardizuar dhe të mbështetur në të dhëna. Sfida kryesore mbetet kalimi nga një qasje kryesisht përshkruese dhe funksionale drejt një qasjeje sistematike, analitike dhe zhvillimore, ku tregu i punës, punësimi, praktika profesionale dhe zhvillimi i kompetencave të shërbejnë si instrumente reale për planifikimin, rishikimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit.

4.2.Rekomandime

Në funksion të gjetjeve të këtij raporti tematik, rekomandohet që institucionet e arsimit të lartë të orientojnë përpjekjet drejt konsolidimit të një qasjeje më të strukturuar dhe të qëndrueshme për lidhjen e programeve të studimit me tregun e punës:

Së pari, institucionet e arsimit të lartë duhet të formalizojnë studimin e tregut të punës si proces periodik institucional. Këto studime duhet të bazohen në indikatorë të matshëm, të dokumentojnë kërkesat për profile profesionale dhe kompetenca kyçe, si dhe të shërbejnë si bazë e drejtpërdrejtë për vendimmarrjen në hapjen, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit.

Së dyti, rekomandohet ndërtimi i mekanizmave të standardizuara për gjurmimin e studentëve dhe të të diplomuarve, përmes databazave funksionale të alumni-ve, pyetësorëve periodikë dhe raportimit të rregullt të treguesve të punësimit. Këto të dhëna duhet të shërbejnë si indikatorë performance për programet dhe si bazë për rishikime kurrikulare të mbështetura në evidencë.

Së treti, praktika profesionale duhet të trajtohet si proces i integruar pedagogjik, me objektiva të qarta, standarde të përbashkëta, mekanizma vlerësimi dhe dokumentim sistematik të rezultateve dhe feedback-ut nga institucionet pritëse. Kjo do të mundësonte përdorimin e saj si një instrument real për përmirësimin e cilësisë dhe punësueshmërisë.

Së katërti, rekomandohet forcimi i lidhjes ndërmjet kompetencave, rezultateve të të nxënit dhe vlerësimit, në mënyrë që kompetencat profesionale dhe të transferueshme të shndërrohen në rezultate të matshme dhe të krahasueshme të programeve të studimit.

Së fundmi, përfshirja e aktorëve të jashtëm dhe punëdhënësve duhet të kalojë nga një rol kryesisht funksional drejt një bashkëpunimi strategjik, të dokumentuar dhe të integruar qartë në zhvillimin e kurrikulave dhe në ciklin e sigurimit të cilësisë.



www.ascal.al



info@ascal.al